

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 7033  
E shtunë, 28 tetor 2023  
Çmimi 0.50 €

Mustafa: ZPS-ja nuk është as një për qind afër realitetit që ka ndodhur gjatë vitit 1999 IFAQE 9



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

PA NDONJË PËRPARIM, KOSOVA DHE SERBIA PËRMBYLLËN EDHE NJË MARATONË TAKIMESH NË BRUKSEL IFAQE 4-5

## KURTI PRANON DRAFTIN E RI PËR ASOCIACIONIN, OPOZITA QË NUK DI PËRMBAJTJEN E TIJ, E FTON NË KUVEND



Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë ka përfunduar pa ndonjë rezultat në Bruksel. Kurti dhe Vuçiçi kanë dhënë deklarata të kundërta pas takimeve që kanë zhvilluar ndaras me diplomatët evropianë. Kurti në takim ishte i

gatshëm ta nënshkruante draftin e ri të diplomatëve evropianë për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, Vuçiçi insistoi në zbatim të marrëveshjeve të kaluara. Shefi i politikës së jashtme i BE-së, Josep Borrell, tha se marrëveshja

mes tyre nuk ishte e mundur sepse "parakushtet e njërës palë ishin të papranueshme për tjetrën". Opozita e ka akuzuar Kurtin që ka pranuar një dokument që u jep autonomi serbëve në veri, prandaj e ka ftuar për raportim në Kuvend

### AKTUALE



SHEFJA E KOMISIONIT EVROPIAN VIZITON BALLKANIN PERËNDIMOR F. 2

UJI NGA LIQENI I BADOCIT ENDE NUK MUND TË PËRDORET PËR PIJE F. 3

ALI AHMETI TAKON GRESELLIN, FLASIN PËR THAÇIN DHE DIALOGUN KOSOVË - SERBI F. 7

### EKONOMI



"PAGA MË DEL PËR GJYSMË MUAJI", EKSPERTËT: DUHET TË RRITET VLERA E KOEFICIENTIT F. 8

AMBASADORI I BE-së: JEMI TË INTERESUAR TË PËRSHPEJTOJMË NJË TRANZICION TË DREJTË ENERGETIK F. 8

### SPORT



KOSOVA REALIZON FITOREN E PARË NË LIGËN E KOMBEVE F. 10

LIDERËT E BE-së DËNOJNË SULMIN NË BANJSKË, KËRKOJNË NGA KOSOVA DHE SERBIA T'I ZBATOJNË TË GJITHA MARRËVESHJET IFAQE 3



MINATORËT VAZHDOJNË GREVËN, DISAVE U PËRKEQËSOHET GJENDJA SHËNDETËSORE IFAQE 5



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Shefja e Komisionit Evropian viziton Ballkanin Perëndimor

**BRUKSEL, 27 TETOR** - Shefja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, do të nisë të dielën një vizitë katërditore në Ballkanin Perëndimor. Atë ditë shefja e bllokut evropian do të takohet me zyrtarë të Maqedonisë së Veriut, ndërsa të hënën do të jetë në Prishtinë për t'u takuar me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti. Në ditën pasuese ajo do t'i vizitojë Podgoricën dhe Beogradin, ndërsa të mërkurën do ta

mbarojë vizitën në Sarajevë. Ajo do të takohet me liderët e të gjitha shteteve. Vizita e saj në këto vende të Ballkanit vjen pas një vizite të saj në Shqipëri më 15-16 tetor. Atje von der Leyen ka marrë pjesë në samitin e Procesit të Berlinit. Në atë samit është bërë thirrje që ky rajon të bëhet sa më shpejt anëtar i Bashkimit Evropian. Procesi i Berlinit nuk është një proces formal i politikës së BE-së ndaj rajonit të Ballkanit

Perëndimor. Është një nismë e Gjermanisë, e mbështetur nga vendet e tjera të BE-së si Austria, Sllovenia, Kroacia e pastaj edhe Franca, Italia, Polonia dhe të tjera, që ka për qëllim të ndihmojë në zhvillimin e rajonit, bashkëpunimin e ndërsjellë mes tyre, ta sigurojë tërheqjen e investimeve dhe në këtë mënyrë t'i ndihmojë ato vende në përgatitjen e tyre për anëtarësim në BE në një të ardhme.



## OKB-ja: Jemi të shqetësuar se po kryhen krime lufte në konfliktin Izrael - Hamas

**GAZA, 27 TETOR** - Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) tha të premten se ndihet e shqetësuar se po kryhen krime lufte nga të dyja palët në konfliktin në mes të Izraelit dhe Hamasit.

Zyra e OKB-së për të Drejtat e Njeriut përmendi ndëshkimin kolektiv, marrjen e pengjeve dhe zhvendosjen e detyrueshme gjatë luftës që tashmë ka hyrë në ditën e 21-të të saj. "Ne jemi të shqetësuar se po kryhen krime lufte. Ne jemi të brengosur për ndëshkimin kolektiv të banorëve të Gazës si përgjigje ndaj sulmeve mizore nga Hamasi, të cilat ishin krime lufte, po ashtu", tha të premten zëdhënësja e Zyrës së OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Ravina Shamdasani.

Ajo tha se i takon një gjykatë të pavarur ligjore të thotë nëse janë kryer krime lufte.

Izraeli është duke e bombarduar paseshtur Gazën prej se militantët e Hamasit i thyen pengesat kufitare dhe u futën nga Gaza në qytetet e Izraelit jugor, duke i vrarë 1 400 njerëz, kryesisht civilë, dhe duke i rëmbyer 224 të tjerë, sipas zyrtarëve izraelitë.

Në bombardimet hakmarrëse izraelite janë vrarë së paku 7 028



palestinezë në Rripin e Gazës, përfshirë 2 913 fëmijë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në Gazë, e cila udhëhiqet nga Hamasi.

Numri i të vdekurve i dhënë nga Hamasi nuk mund të verifikohet në mënyrë të pavarur.

Izraeli e ka rrethuar Gazën dhe e

ka ulur furnizimin me ushqim, ujë dhe rrymë, duke e ndaluar plotësisht furnizimin me karburant, për të cilin thotë se po shfrytëzohet nga Hamasi për të prodhuar armë dhe eksplozivë. Ushtria e Izraelit u bëri thirrje banorëve në veri të Rripit të Gazës - gjysmës së popullsisë prej 2.3

milione - të shkojnë në jug para ofensivës së prishme tokësore. "Askush nuk është i sigurt në Gazë. T'i detyrosh njerëzit të evakohen në këto kushte... dhe nën rrethim të plotë, ngrë shqetësime serioze për zhvendosje të detyrueshme, gjë që është krim lufte", tha

Shamdasani. "Përdorimi i armëve shpërthyes me ndikim të gjerë nga Izraeli në zonat e populluara dendësisht, ka shkaktuar dëme të mëdha në infrastrukturën civile dhe humbje jetësh në civilë që, nga ajo që shihet, është e vështirë të jenë në pajtim me ligjin humanitar ndërkombëtar", tha ajo.

Shamdasani tha se një katastrofë humanitare po ndodh për njerëzit e Gazës "të cilët janë të ngjuar brenda Gazës dhe po ndëshkohen kolektivisht. Ndëshkimi kolektiv është krim lufte. Izraeli duhet patjetër ta ndalë menjëherë ndëshkimin e tërë popullit të Gazës".

Ajo tha se edhe sulmet e grupeve të armatosura palestineze, përfshirë ato përmes lëshimit të raketave nga Gaza në Izrael, duhet të ndalen. "Ata duhet patjetër dhe pa kushte t'i lirojnë të gjithë civilët që po i mbajnë. Të marrësh pengje është krim lufte", nënvizoi ajo.

Krimi i luftës është shkelje serioze e ligjit ndërkombëtar kundër civilëve dhe luftëtarëve gjatë konflikteve të armatosura, si dhe shkelje serioze e Konventës së Gjenevës nga viti 1949.

## Guvernatorja e Meinit: 18 të vrarë nga sulmi masiv, i dyshuari në arrati

**MEINIT, 27 TETOR** - Guvernatorja e Meinit në Shtetet e Bashkuara, Janet Mills, ka thënë se 18 persona janë vrarë dhe 13 janë plagosur si pasojë e sulmeve me armë zjarri në mesnatën e së enjtes. Një burrë ka shtënë me armë zjarri dhe i ka vrarë viktimat në një sallë të boullingut dhe në një restorant në Leviston, më pas ka ikur.

Autoritetet kanë nisur kërkime masive për ta gjetur atë dhe u kanë kërkuar banorëve që të qëndrojnë nëpër shtëpitë e tyre.

Mills ka thënë se i dyshuari është Robert Card, i cili konsiderohet i armatosur dhe i rrezikshëm, andaj autoritetet kanë kërkuar t'i qëndrojnë larg, nëse e shohin. Policia e ka identifikuar Card si 40-vjeçar, person me interes për këtë sulm në Leviston.

Ai është thënë se ka qenë instruktor armësh në forcën rezervë të ushtrisë amerikane. Sipas informacioneve të policisë, Card ka qenë i shtruar për trajtim për dy javë në një qendër të shëndetit mendor, pa dhënë hollësi për llojin e

trajtimit që ka marrë. Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, ka biseduar gjatë ditës me guvernatorin Mills, si dhe me anëtarët e Senatit dhe të Dhomës së Përfaqësuesve, duke iu ofruar atyre "mbështetje të plotë federale pas këtij sulmi të tmerrshëm", ka thënë Shtëpia e Bardhë. Në Mein nuk kërkohet leje për armëmbajtje dhe ky shtet e ka një kulturë të moçme të armëmbajtjes që ndërlihet me traditat e tij për gjueti dhe për qitje sportive.



# Ish-kryeministrit Berisha i kërkohet të paraqitet në SPAK dy herë në muaj

**TRIANË, 27 TETOR** - Ish-kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, duhet të paraqitet dy herë në muaj para Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) për t'u marrë në pyetje, thanë autoritetet.

Berisha dyshohet për "korrupsion pasiv të kryer në bashkëpunim", në rastin e privatizimit të ish-kompleksit sportiv "Partizani".

Vendimi u mor pasi për tri ditë me radhë u mbajtën disa seanca maratonë dhe pas ndryshimit të disa avokatëve si përfaqësues të ish-kryeministrit.

Gjykata vendosi për vazhdimin e masës së sigurisë me karakter shtrëngues, "detyrim për t'u paraqitur" për Sali Berishën.

Sipas vendimit të gjykatës, "urdhërohet shtetasi nën hetim, Sali Berisha, të paraqitet të hënën e parë dhe të tretë të çdo muaji para policisë gjyqësore në SPAK. Po ashtu gjykata ka urdhëruar që Berisha "të mos largohet nga territori i Shqipërisë pa autorizim të gjykatës si dhe ndalohet përdorimi i pasaportës dhe i dokumenteve të tjera identifikuese të vlefshme për daljen jashtë shtetit".

Për caktimin e masës së sigurisë për ish-kryeministrit, Sali Berisha u deshën tri ditë kohë. Kjo ndodhi fillimisht për shkak të tërheqjes së avokatëve Genc Gjokutaj dhe Sokol Mëngjesi, të përzgjedhur nga ish-kryeministri Sali Berisha për ta përfaqësuar në gjykatë. Ata u tërhoqën sepse e cilësuan të parregullt procesin



ndaj ish-kryeministrit. Ndërsa vetë Berisha deklaroi se nuk do të paraqitej në gjykatë, pasi i cilëson akuzat ndaj tij të pabaza dhe të motivuara politikisht. Në këto kushte, mbrëmjen e së mërkurës, gjykata vendosi që të caktonte avokat nga shteti.

Por, vetëm pak orë pasi avokati Artan Simoni mori përsipër mbrojtjen, ai u tërhoq për shkak të një postimi në rrjetet sociale, për të cilin u aludua nga bashkëpunëtorë të Berishës se lidhej pikërisht me ish-kryeministrit. Mëngjesin e së enjtes gjykata caktoi dy avokatet e tjera Jall Diz Kastrati dhe Rabije Cenalla, që ta mbronin ish-

kryeministrit në seancën për masën e sigurisë.

Ato morën 5 orë kohë për t'u njohur me dosjen, por për arsye të paqarta dhe të papublikuara, të dyja u tërhoqën në nisje të seancës në orën 15:00. Tërheqja e tyre u mësua pas përfundimit të seancës, kur gjykata bashkë me vendimin e marrë, bëri me dije se tashmë është caktuar një tjetër avokate nga shteti, Valentina Todorosku.

Pavarësisht prej kohëzgjatjes, tashmë ka një vendim, dhe ish-kryeministri Sali Berisha mund të ankimohej për masën e sigurisë në Gjykatën e Posaçme të Apelit, si dhe në Gjykatën e Lartë.

Për çështjen e privatizimit të ish-kompleksit "Partizani" është arrestuar Jamarbër Mallezi, dhëndri i ish-kryeministrit Sali Berisha. Ai akuzohet për "korrupsion pasiv në bashkëpunim" si dhe për "pastrim parash". Ndërsa ortaku i tij, ndërtuesi Fatmir Bektashi, po hetohet nën masën e sigurisë "detyrim paraqitjeje".

Hetimet nga SPAK nisën pas një kallëzimi të dorëzuar në vitin 2020 nga Taulant Balla, tani ministër i Brendshëm. Në kallëzim theksohej se "Jamarbër Mallezi privatizoi kompleksin Partizani në mënyrë të paligjshme me një shumë rreth

100 mijë euro, ndërsa në këtë zonë tashmë janë ngritur disa pallate për banim. Kjo u arrit përmes vendimeve favorizuese të qeverisë së drejtuar nga Sali Berisha".

Kompleksi sportiv "Partizani", me një sipërfaqe prej 26 mijë metrash katrorë, u privatizua në vitin 2008. Deri në atë kohë ishte pronë e Ministrisë së Mbrojtjes.

Rreth 22 mijë metra katrorë iu përkisnin 64 trashëgimtarëve të pesë familjeve të ish-pronarëve, mes tyre edhe Jamarbër Mallezi, ndërsa 4 mijë metra katrorë të tjerë ishin pronë shtetërore. Në fund të procesit të kthimit të kësaj prone, Jamarbër Mallezi arriti të marrë 35 për qind të të gjithë pjesën që ishte tokë shtetërore.

Sipas padisë së dorëzuar në SPAK, kjo është bërë përmes vendimeve të dyshimta të Qeverisë së Sali Berishës. Në atë sipërfaqe të përfutur, Jamarbër Mallezi së bashku me ortakun e tij Fatmir Bektashi kanë ndërtuar disa kulla. Për këto ndërtime, në kallëzimin e dorëzuar në Prokurori, theksohet se nuk dihet burimi i të ardhurave. Për këtë çështje janë thirrur në SPAK disa ish-ministra të Mbrojtjes dhe të Ekonomisë nga Qeveria e atëhershme e Berishës. Ish-kryeministri Sali Berisha, dhe familja e tij, përfshirë edhe dhëndrin Jamarbër Mallezi, janë shpallur persona të padëshiruar (non grata) nga Shtetet e Bashkuara, nën dyshimet se janë të përfshirë në korrupsion të lartë dhe cenim të demokracisë.

## Uji nga Liqeni i Badocit ende nuk mund të përdoret për pije



**PRISHINË, 27 TETOR** - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar të enjten se qytetarët që furnizohen nga Liqeni akumulues i Badocit ende nuk mund ta përdorin ujin për pije.

Uji që përpunohet nga Liqeni i Badocit nuk mund të përdoret për

pije prej 19 tetorit për shkak të sasisë së madhe të detektuar të elementit kimik mangan.

Ekspertët e ujërave kanë thënë ditë më parë se vlerat e shtuara të manganit në ujin e Liqenit të Badocit janë pasojë e faktorëve natyrorë dhe njerëzorë.

Sipas një raporti të Organizatës

Botërore të Shëndetësisë, mangani është një element esencial për shumë gjallesa, përfshirë këtu edhe njerëzit.

Por, "efekte të padëshirueshme në shëndetin e njerëzve mund të shkaktohen nga marrja e pamjaftueshme ose ekspozimi i tepërt [ndaj manganit]".

Megjithatë, IKShPK-ja ka njoftuar se uji mund të përdoret për pastrim, për mirëmbajtje të higjienës dhe ambienteve të banimit.

Sipas një njoftimi për medie, instituti është duke kryer çdo ditë analiza fiziko-kimike të ujit për t'i kontrolluar vlerat.

Për dallim prej ujit të Badocit,

qytetarët që furnizohen me ujë prej Liqenit të Batllavës dhe Ujmanit mund ta përdorin ujin pa asnjë kufizim.

Nga fabrika e ujit në Liqenin e Badocit furnizohen qytetarët e pjesës më të madhe të Prishtinës dhe të komunave dhe fshatrave përreth.



PA NDONJË PËRPARIM, KOSOVA DHE SERBIA PËRMBYLLËN EDHE NJË MARATONË TAKIMESH NË BRUKSEL

# Kurti pranon draftin e ri për asociacionin, opozita që nuk di përmbajtjen e tij, e fton në Kuvend

Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë ka përfunduar pa ndonjë rezultat në Bruksel. Kurti dhe Vuçiqi kanë dhënë deklarata të kundërta pas takimeve që kanë zhvilluar ndaras me diplomatët evropianë. Kurti në takim ishte i gatshëm ta nënshkruante draftin e ri të diplomatëve evropianë për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, Vuçiqi insistoi në zbatim të marrëveshjeve të kaluara. Shefi i politikës së jashtme të BE-së, Josep Borrell, tha se marrëveshja mes tyre nuk ishte e mundur sepse “parakushtet e njëres palë ishin të papranueshme për tjetrën”. Opozita e ka akuzuar Kurtin që ka pranuar një dokument që u jep autonomi serbëve në veri, prandaj e ka ftuar për raportim në Kuvend

zëvendëspresidentin e Komisionit Evropian dhe përfaqësuesin e Lartë për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë, Josep Borrell, si dhe emisarin e tij, Miroslav Lajcak, kryeministri Kurti i ka falënderuar të gjithë ata për rolin, angazhimin dhe kontributin për paqe dhe normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë.

Shefi i politikës së jashtme u BE-së, Josep Borrell, i cili ndërmjetësoi bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi, tha se marrëveshja mes tyre nuk ishte e mundur, sepse “parakushtet e njëres palë ishin të papranueshme për tjetrën”. Ai konfirmoi se temë e diskutimeve në Bruksel ishte propozimi i ri i diplomatëve perëndimorë për statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, i cili u prezantua në Prishtinë dhe në Beograd më 21 tetor. “Palët nuk ishin të gatshme të bien dakord për të pa parakushte, e që janë të papranueshme për palën tjetër. Në fund, ne kërkojmë që palët të

angazhohen sinqerisht në procesin e normalizimit”, tha Borrelli. Sipas tij, kjo “mund të bëhet vetëm në kuadër të dialogut, sepse është e vetmja mënyrë për të përparuar në rrugën evropiane”. “Ne do të vazhdojmë të insistojmë dhe të punojmë për të arritur një marrëveshje. Por sot, për fat të keq, nuk ishte e mundur”, tha kryediplomati evropian.

Presidenti serb Aleksandër Vuçiq u tha gazetarëve se Serbia është e gatshme për zbatimin e Asociacionit “në përputhje me propozimet që kemi marrë më 21 tetor”, por theksoi se gjatë bisedimeve me udhëheqësit evropianë “e kam thënë qartë se Serbia nuk mund ta pranojë anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, apo pavarësinë dhe tërësinë tokësore të Kosovës”.

Ai tha se nuk është shtruar çështja e nënshkrimit apo mosnënshkrimit gjatë bisedimeve, ndërsa e cilësoi propozimin e 21 tetorit si një bazë të mirë për vazhdimin e diskutimeve në të

**EPOKA E RE****Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 27 TETOR** - Kryeministri Albin Kurti ka shprehur gatishmëri ta nënshkruajë në Bruksel Marrëveshjen Bazë për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, si dhe draftin e ofruar nga diplomatët perëndimorë për themelimin e Asociacionit, por një gjë të tillë e ka refuzuar presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq. “Kryeministri Kurti rikujtoi që ai ishte i gatshëm të nënshkruajë edhe në Bruksel më 27 shkurt 2023 edhe në Ohër më 18 mars 2023, edhe sonte, më 26 tetor 2023, duke

theksuar që pikërisht Samiti i Këshillit Evropian në Bruksel është ngjarja e duhur, në vendin e duhur, për nënshkrim të Marrëveshjes Bazike, përfshirë edhe draftin e ofruar nga BE-ja dhe ShBA-ja për zbatimin e nenit 7 në ndërlidhje të nenit 10 të Marrëveshjes Bazike. Përkundër kësaj oferte gjeneroze të kryeministrit Kurti, presidenti i Serbisë, Vuçiq, ka refuzuar të nënshkruajë marrëveshje me Kosovën, dhe ka kërkuar t'i pranohet një letër anësore me të cilën praktikisht i zhbën tri parime të Marrëveshjes Bazë, të Aneksit të Zbatimit si dhe të draftit të propozuar nga pesë emisarët më

21 tetor 2023”, ka njoftuar Qeveria e Kosovës, duke theksuar se Republika e Kosovës e ka pranuar Marrëveshjen Bazike të Brukselit të 27 shkurtit 2023 dhe Aneksin Zbatues të Ohrit të 18 marsit 2023. “Këto dokumente të dakorduara janë një sukses i përbashkët me Bashkimin Evropian. Marrëveshja duhet zbatuar në tërësi, pa kushte, pa vonesa”, thuhet në njoftimin e Qeverisë së Kosovës.

Në takimin me kancelarin e Gjermanisë, Olaf Scholz, me presidentin e Francës, Emmanuel Macron, kryeministren e Italisë, Giorgia Meloni, presidentin e Këshillit Evropian, Charles Michel,

# Mustafa: ZPS-ja nuk është as një për qind afër realitetit që ka ndodhur gjatë vitit 1999

HAGË, 27 TETOR - Në seancën e së premtes të Apelit, gjatë deklarimit të tij, Salih Mustafa, i dënua me 26 vjet burgim nga Gjykata Speciale për krime lufte, ka thënë se ndihet i pafajshëm për veprat për të cilat është dënua.

Në deklarin e tij, Mustafa tha se ndihet moralisht dhe praktikisht i pafajshëm edhe pse juridikisht gjykata e ka shpallur të fajshëm. "Unë kisha për të thënë që edhe praktikisht edhe moralisht ndihem i pafajshëm edhe pse juridikisht gjykata më ka shpallur të fajshëm, për shkak se jam i bindur që absolutisht asnjë veprë për ato çka m'i ka ngarkuar prokuroria që tri vjet nuk i kam konsumuar", tha Mustafa.

Ai tha se është i sigurt që Zyra e Prokurorit të Specializuar e di saktë që nuk është ashtu dhe se realiteti se si ka ndodhur gjatë viteve 1999 është ndryshe. "Unë jam shumë i sigurt se prokuroria i ka të gjitha provat dhe e di saktë që nuk është ashtu dhe nuk është afër, as edhe një për qind të atij realiteti që ka ndodhur gjatë vitit

1999", tha Mustafa.

Ai u shpreh i bindur se prokuroria me dashje i ka vendosur të gjitha argumentet me "kokë poshtë". "Unë jam i bindur që prokuroria me dashje të gjitha argumentet i ka vendosur me kokë teposhtë duke mos i pa prej deklaratave fillestare të vet dëshmitarëve të prokurorisë e deri te marrja e vendimit të trupit gjykues", tha Mustafa.

Më tutje, Mustafa tha se beson në drejtësi. "Prandaj nuk kam diçka tjetër. Kam besim në ju. Unë jam shumë i sigurt që moralisht dhe praktikisht jam i pafajshëm", tha ai.

Në parashtrimet e saj shtesë, mbrojtja e Salih Mustafës përmes avokatit Julius Von Bone tha se dokumenti i cili ishte paraqitur nga Zyra e Prokurorit të Specializuar e që mbante një listë të të burgosurve nuk vlen asgjë në këtë çështje.

Von Bone tha se ky dokument nuk tregon se ku janë mbajtur njerëzit e ndaluar. "Prokuroria tregoi një dokument, një listë të



burgosurish. E pamë atë, dhe ky dokument, në fakt, çka do që të jetë vlera e tij, nuk vlen asgjë. Nuk vlen asgjë në këtë çështje se ky dokument nuk tregon fare se ku

janë mbajtur njerëzit e ndaluar dhe, për më tepër, nuk tregon asgjë lidhur me lirin e ndonjë nga personat e renditur në atë listë apo që është i rëndësishëm në

këtë çështje", tha Von Bone.

Avokati Von Bone tha se lidhja e Salih Mustafës me këtë dokument nuk është vërtetuar kurrë. (betimipërdrejtësi)

## Liderët e BE-së dënojnë sulmin në Banjskë, kërkojnë nga Kosova dhe Serbia t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet



PRISHTINË, 27 TETOR - Krerët e shteteve dhe qeverive të Bashkimit Evropian e kanë dënua "ashpër sulmin e dhunshëm ndaj Policisë së Kosovës", që ka ndodhur në Banjskë të Zveçanit më 24 shtator. "Bashkimi Evropian pret që autorët të arrestohen dhe të sillen shpejt para drejtësisë dhe Serbia të bashkëpunojë plotësisht dhe t'i ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm në këtë drejtim", është thënë në konkluzionet e miratuara në fund të samitit.

Në fund të takimit dyditor, të mbajtur në Bruksel, liderët e BE-së

kanë shprehur shqetësimin e tyre të thellë për situatën e sigurisë në veri të Kosovës.

Kosovës dhe Serbisë u është kërkuar t'i vazhdojnë përpjekjet për ulje të tensioneve dhe ta sigurojnë mbajtjen sa më të shpejtë të zgjedhjeve të reja në veri të Kosovës, me pjesëmarrjen aktive të serbëve të Kosovës. "Dështimi për t'i ulur tensionet do të ketë pasojë", është thënë në konkluzione.

Presidentët dhe kryeministrat evropianë kanë shprehur keqardhje për mungesën e zbatimit

të Marrëveshjes së arritur në shkurt në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizim të marrëdhënieve.

BE-ja ka bërë thirrje që dy vendet t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet paraprake, pa vonesa dhe pa parakushte, duke përfshirë edhe formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. "Normalizimi i marrëdhënieve është një kusht thelbësor në rrugën evropiane të të dyja palëve dhe të dyja rezikojnë të humbasin mundësi të rëndësishme në mungesë të progresit", thuhet në dokumente.

ardhmen.

Deputetja e Kuvendit të Kosovës nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Blerta Deliu-Kodra, ka thënë se me pranimin e këtij drafti të asociacionit, Kurti i ka bërë dëm të madh vendit. "Kryeministri Kurti i ka bërë dëm të pariparueshëm funksionimit të shtetit të Kosovës përmes pranimit të këtij drafti, sepse njohja reciproke nuk është askund, nuk e përmend kryeministri, e përmend Asociacionin, statusin, vetëmenaxhimin për serbët, por jo njohjen 'de-jure' të Kosovës. Kjo ka ndodhur me këtë qeveri të Albin Kurtit, nga njohja reciproke në qendër, kemi pranim të autonomisë të serbëve të Kosovës", ka thënë ajo në Kuvendin e Kosovës.

Shefi i grupit parlamentar i LDK-së,

Arben Gashi, ka kërkuar nga kryeministri Kurti të raportojë në Kuvendin e Kosovës për atë që ka ndodhur të enjten në Bruksel. Ai ka thënë se Kurti ka pranuar statutin e Asociacionit të cilin e kishte kritikuar si lëvizje politike.

Gashi ka thënë se Kurtin nuk mund ta kritikojë për përmbajtjen e draftit të Asociacionit, pasi nuk e di se çfarë përmban ai dokument. "Me atë çka pamë dje, Kurti ka pranuar një draft të statutit të Asociacionit, të paktën kështu tha publikisht. S'po e gjykoj nëse është i mirë apo i keq, se nuk e di. Nuk e kam parë. Por, si ndodhi që diçka e papranueshme, që janë humbur 10 vjet për të, tash të pranohet. Çka ndodhi me Asociacionin kundër të cilit u vranë njerëz në këtë vend?", ka thënë Gashi.

Ndërkaq lideri i Aleancës për

Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka mbështetur kryeministrin Kurti në pranimin e draftit të ri të BE-së për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. "Kosova dje ka bërë një hap të madh përpara. Kryeministri Kurti me pranimin e propozimit të pesëshes për implementimin në këtë rast, e ka vendosur Kosovën në pozicion të duhur, në këtë kohë pas shumë gabimeve dhe pas një kohe të gjatë të humbur në dialog", ka deklaruar Haradinaj.

Dështimi që Kosova dhe Serbia të arrijnë një pajtim apo marrëveshje në bisedimet e së enjtes në Bruksel, duhet të jetë alarm për ndërmjetësuesit perëndimorë se qasja e deritashme në dialog nuk funksionon, thonë njohësit e zhvillimeve politike në Prishtinë dhe Beograd, Artan Muhaxhiri dhe

Ognjen Gogiq. Sipas tyre, deklaratat e kryeministrat të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, pas takimeve të së enjtes, janë të ngjashme me ato në mars, kur dy udhëheqësit janë pajuar për zbatimin e Marrëveshjes Bazë për normalizimin e marrëdhënieve: akuza të ndërsjella, zotime të papërmblushura.

Njohësi i zhvillimeve politike në Prishtinë, Artan Muhaxhiri, thotë se qasjet e ndërmjetësuesve të BE-së në dialog, por edhe të Kurtit dhe të Vuçiqit të enjten, kanë qenë të ngjashme me takimet e mëhershme dhe "shterpë". "Dështimi i këtij takimi duhet të jetë leksion për Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës që të punojnë në riformatizimin e dialogut, në

mënyrë që ai të jetë maksimalisht i efektshëm. Dialogu është bërë qëllim në vete dhe duket se nuk ka indikacione se jemi duke shkuar drejt arritjes së marrëveshjes finale dhe zvogëlimit të hendekut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë", ka thënë Muhaxhiri për "Radion Evropa e Lirë".

Politologu serb Ognjen Gogiq thotë se po të kishin të dërguarit perëndimorë "një shkop apo karotë, që në një mënyrë të ndikonin te palët, ata do ta shfrytëzonin atë ndikim qysh në dimër", kur është arritur Marrëveshja Bazë. "Nëse këtu do të kishte një 'djalë të keq', ai do të ishte Bashkimi Evropian, sepse mendoj se gjërat do të dukeshin ndryshe sikur të ekzistonte perspektiva e anëtarësimit [në Bashkimin Evropian]", ka thënë Gogiq.

## Kryetari i Vushtrrisë dhe ambasadori i Finlandës hapën kampanjën njoftuese "Pa viza"

Vushtrri, 27 tetor - Kryetari i Vushtrrisë, Ferit Idrizi, ka pritur në takim ambasadorin e Finlandës në Kosovë, Matti

Nissinen. Idrizi ka bërë me dije se me ambasadorin Nissinen biseduan për mundësitë e bashkëpunimit në mes të

Ambasadës së Finlandës dhe komunës së Vushtrrisë në fushën e kulturës, të arsimit dhe në fushat e tjera. "Gjithashtu,

bashkë me ambasadorin hapëm kampanjën njoftuese 'Pa viza' për qytetarët në sheshin e qytetit", ka thënë Idrizi.



## Arrestohen dy persona për grabitje të armatosur në Kaçanik

**KAÇANIK, 27 TETOR** - Më 26 tetor rreth orës 04:55 policia rajonale e Ferizajt ka pranuar një informacion, se në rrugën magjistrale Ferizaj - Kaçanik, në hyrje të Kaçanikut, në një pikë karburanti është një rast i grabitjes së armatosur.

Në lidhje me këtë ekipet e policisë të Stacionit në Kaçanik kanë marrë veprimet e nevojshme dhe menjëherë kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe nga aty kanë mësuar se një person i maskuar dhe nën kërcënimin e armës së zjarrit me pushkë automatike ka arritur të grabisë një shumë të caktuar të të hollave

dhe të largohet këmbë në drejtim të panjohur.

Në vendin e ngjarjes kanë arritur hetuesit dhe krimteknikët rajonalë dhe kanë nisur kërkimin e personave të dyshuar. "Hetuesit rajonalë, pas një pune intensive hetimore, grumbullimit të informacioneve në terren, shikimit të kamerave të sigurisë, kanë arritur të identifikojnë dy persona, të cilët dyshohet se kanë kryer grabitjen, ndërsa kanë bastisur dy lokacione të dy personave të dyshuar dhe aty kanë gjetur e më pas kanë konfiskuar: 3 armë të zjarrit, 2 pushkë automatike dhe një

pistoletë, sasi të municionit, karikatorë, një radiolidhje, sasi të narkotikëve, një shufër metalike, dorëza, maskë, telefona, me të cilat dyshohet se është kryer grabitja. Dy të dyshuarit K. Ç. (M/K), i moshës 22-vjeçar dhe A. Ç. (M/K), i moshës 21-vjeçar, janë arrestuar dhe shoqëruar në Sektorin Rajonal të Hetimeve dhe pas intervistimit nga policët hetues, me vendim të prokurorit të rastit, janë ndaluar në mbajtje për 48 orë për procedura të tjera hetimore, ndërsa rasti është cilësuar 'Grabitje dhe armëmbajtje pa leje', ka njoftuar Policia e Kosovës.



## Paraqitet draft-strategjia e zhvillimit të arsimit në komunën e Drenasit

**DRENAS, 27 TETOR** - Në sallën e Kuvendit Komunal të Drenasit, para drejtorëve të institucioneve arsimore, është bërë paraqitja e projektit "Strategjia pesëvjeçare e zhvillimit të arsimit në komunën e Drenasit".

Paraqitjen e kësaj strategjisë e ka bërë profesor Halim Hyseni.

Në këtë paraqitje mori pjesë edhe kryetari Ramiz Lladrovci bashkë me drejtorin e Arsimit në komunën e Drenasit, Muhamet Gjoka dhe drejtorin ekzekutiv në "QAPA", Nehat Mustafa.

Me këtë rast kryetari Lladrovci falënderoi drejtorët e shkollave, drejtorin e Arsimit, përfaqësuesit

e "QAPA" për angazhimin e vazhdueshëm në funksion të përmirësimit të cilësisë së arsimit në komunën e Drenasit.

Lladrovci inkurajoi drejtuesit e institucioneve arsimore që të angazhohen maksimalisht në mënyrë që shkollat e kësaj komune të jenë shkolla model në nivel vendi.

"Strategjia pesëvjeçare e zhvillimit të arsimit" në komunën e Drenasit është pjesë e projektit "Avancimi i përsheptuar i arsimit në komunën e Drenasit", i implementuar nga ekspertët e arsimit (QAPA), financuar nga komuna e Drenasit.



## Haradinaj e viziton Hamzën, diskutojnë për zhvillimet e fundit në rajonin e Mitrovicës



**MITROVICË, 27 TETOR** - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, së bashku me kryetarin e degës së kësaj partie në Mitrovicë, Qazim Nimani, kanë takuar kryetarin e komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza.

Haradinaj ka bërë me dije se me Hamzën kanë diskutuar për zhvillimet e fundit në rajonin e Mitrovicës dhe për problemet me

të cilat po përballen aktualisht kjo trevë. "Shprehja shqetësimin për situatën e krijuar në 'Trepçë' që i ka shtyrë minatorët të hynë në grevë, por edhe për neglizhencën e qeverisë qendrore në Prishtinë në raport me Trepçën", ka thënë ai.

I pari i AAK-së ka thënë se kryeministri Kurti dhe qeveria me eksperimentet e tyre dhe veprimet pas shpine ndaj qytetarëve e ndaj

aleatëve i kanë humbur tre vjet të çmuara jo vetëm Mitrovicës, por gjithë vendit, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme të cilat po reflektojnë edhe në zbrazjen e vendit. "Është momenti i fundit që këto praktika eksperimentale të ndalen dhe Kosova urgjentisht t'i kthehet rrugës së saj euroatlantike. Vetëm nën ombrellën e NATO-s jemi të sigurt!", ka thënë Haradinaj pas takimit.

## Policia ndalon në Prizren 15 migrantë nga Siria, Somalia, Eritrea dhe Egjipti

**PRIZREN, 27 TETOR** - Policia ka ndaluar 15 migrantë në Vërmicë, të cilët dyshohen se kanë hyrë në territorin e Kosovës nga Shqipëria. Ata janë nga Siria, Somalia,

Eritrea dhe Egjipti. "Njësitë policore ka ndaluar 15 persona, shtatë nga Siria, katër nga Somalia, 3 nga Eritrea dhe 1 nga Egjipti, të cilët kanë deklaruar se janë

futur nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Kosovës nga tre persona të dyshuar me një furgon deri afër kufirit, pastaj këmbë janë futur në Kosovë",

bëhet me dije në njoftimin për medie. Lidhur me rastin janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për procedura të mëtejshme hetimore.



## Ali Ahmeti takon Grenellin, flasin për Thaçin dhe dialogun Kosovë - Serbi

SHKUP, 27 TETOR - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka pritur në takim Richard Grenellin, ish-i dërguar special i ish-presidentit amerikan Donald Trump për dialogun Kosovë - Serbi, si dhe ish-shef i shërbimit kombëtar amerikan të inteligjencës. Ahmeti ka bërë me dije se në

këtë takim kanë diskutuar për zhvillimet në rajon, në veçanti midis Prishtinës dhe Beogradit dhe bashkërisht thanë se normalizimi i marrëdhënieve nëpërmjet njohjes së ndërsjellë do të sillte paqe të qëndrueshme në tërë rajonin. "Gjithashtu folëm edhe për procesin në Hagë ndaj ish-presidentit Hashim Thaçi dhe

luftëtarëve të tjerë të lirisë që po mbahen në një proces të stërzgatur padrejtësisht. Z. Grenell më njoftoi që asnjëherë, me asnjë lider politik të rajonit, nuk ka diskutuar mundësinë e përfolur mediatikisht për shkëmbim territorësh midis Kosovës dhe Serbisë, që u mirëprit nga unë", ka thënë Ahmeti.



## Minatorët vazhdojnë grevën, disave u përkeqësohet gjendja shëndetësore



Të premten minatorët e "Trepçës" kanë hyrë në ditën e katërt të grevës, të cilët po qëndrojnë qindra metra në thellësi të tokës. Gjendja e tyre shëndetësore ka filluar të përkeqësohet. Pesë prej tyre janë shtrirë në Spitalin e Mitrovicës. Minatorët e "Trepçës" këmbëngulin se do ta vazhdojnë grevën deri në realizimin e kërkesave të tyre nga qeveria

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

MITROVICË, 27 TETOR - Minatorët e "Trepçës" kanë hyrë në grevë urie prej katër ditësh dhe kanë insistuar se nuk do ta ndërpresin grevën deri në plotësimin e kërkesave, që janë: përmirësimi i kushteve të punës, sigurimi shëndetësor, ekzekutimi me rregull i pagave dhe shkarkimi i kryeshefit. Por

gjendja shëndetësore e disa minatorëve është përkeqësuar dhe është dashur të kërkohet ndihma mjekësore.

Kryetari i Sindikatës së Minatorëve, Ibrahim Jonuzi, ka thënë se disa minatorë kanë mbetur pa vetëdije dhe janë detyruar të kërkojnë ndihmë mjekësore të premtën. Po ashtu, sipas tij, gjendja është alarmante. "Gjendja është alarmante. Ndihma e shpejtë

po vjen dhe po merr punëtorë pasi po u përkeqësohet gjendja. Sot është dita e katërt. Deri më tash janë katër punëtorë që janë dërguar për tretman mjekësor", ka thënë Jonuzi për mediet.

Nënkryetari i komunës së Mitrovicës, Arian Tahiri, ka vizituar të premtën minatorët që janë të shtrirë në spital. Ai ka njoftuar për vizitën në "Facebook". "Sot kam vizituar pesë minatorët e shtrirë në Spitalin e Mitrovicës, të cilëve iu përkeqësua gjendja gjatë grevës. Është e dhimbshme t'i shohësh këta burra në gjendje kaq të rëndë, pasi jemi mësuar t'i shohim vetëm si luanë të nëntokës. Minatorët kanë nevojë për përkrahje nga shteti, pasi gjendja e tyre po rëndohet

në çdo minutë që po kalon", ka thënë Tahiri.

Ndaj kësaj situatë ka reaguar edhe kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, i cili ka thënë se kjo formë e protestës nuk ishte zgjedhje e minatorëve, por ishte zgjidhja e vetme për shkak të injorimit të plotë që u ka bërë qeveria kërkesave të tyre për më shumë se dy vjet. "Kërkesat e tyre janë të drejta dhe të domosdoshme, andaj duhet të plotësohen urgjentisht. Fatkeqësisht, edhe pse kanë kaluar më shumë se 72 orë në grevë, këta qindra minatorë që po qëndrojnë qindra metra në thellësi të tokës, nuk kanë pasur asnjë vizitë nga kryeministri, as nga Ministria e as nga ndonjë tjetër pushtetar. Natyrisht që

ikën - sepse premtimet e tyre të mëdha dje për "Trepçën" dhe minatorët, sot po vërtetohet të kenë qenë vetëm mashtrime", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Ai ka thënë se fshehja nuk është zgjidhje. "E ftoj kryeministrin dhe qeverinë që t'u dalin zot premtimeve të tyre ndaj minatorëve dhe t'i plotësojnë kërkesat që ata kanë. Nuk duhet ta rrezikojnë shëndetin e qindra minatorëve vetëm për ta mbajtur me zor në krye të Trepçës një militant partiak. Qysh sot duhet të ketë veprime që mundësojnë ndërprerjen e grevës. Ne nuk do të heshtim para padrejtësive dhe injorimit që po u bëhet kërkesave të minatorëve tanë - heronjve të nëntokës", ka thënë Krasniqi.

## Ministri i Mbrojtjes sheh nga afër ushtrimin "Iron Wolf" të këmbëtorisë së FSK-së

PRISHTINË, 27 TETOR - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, së bashku me komandantin e Komandës së Forcave Tokësore, gjeneralbrigade Hysen Dreshaj, në Babaj të

Bokës ka vizituar regjimentin e parë të këmbëtorisë, i cili është duke zhvilluar ushtrimin "Iron Wolf", me qëllim të ngritjes së kapaciteteve luftarake të

këmbëtorisë së ushtrisë sonë.

"Përkushtimi, gatishmëria dhe morali i ushtrisë sonë është në nivelin më të lartë. Ngritja e kapaciteteve tona, si në

aspektin e blerjeve të armatimit, ashtu edhe në atë të edukimit, stërvitjeve dhe trajnimeve, është prioriteti ynë kyç", ka thënë ministri Maqedonci.



# 'Paga më del për gjysmë muaji', ekspertët: Duhet të rritet vlëra e koeficientit



**PRISHTINE, 27 TETOR** - "Paga mujore mjafton deri në gjysmë të muajit; nëse del ndonjë shpenzim i paplanifikuar, duhet të marr hua", thotë Isuf Lajçi, mësimdhënësi i matematikës në Shkollën Fillore "Dardania" në Pejë.

Paga bruto e një mësimdhënësi në shkollat fillore të Kosovës është bërë 588 euro qysh në shkurt të këtij viti, nga 421 euro sa ka qenë deri atëherë.

Rritja është realizuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për Paga, sipas të cilit, vlëra e koeficientit të pagave për punonjësit e sektorit publik është bërë 105 euro.

Koeficientet janë nga niveli 2 deri në 18. Niveli shumëzohet me vlërat dhe përcakton pagën.

Duke folur për "Radion Evropa e Lirë", Lajçi thotë se këtë vlerë të koeficientit e ka zhvlerësuar tashmë inflacioni. Sipas tij, rritja e çmimeve të të gjitha produkteve ushqimore dhe shërbimeve e ka bërë të vështirë sigurimin e artikujve të nevojshëm për jetesë. "Më herët me 100 euro i kam marrë produktet e nevojshme, kurse tani për të njëjtat produkte më nevojiten 300 euro", shprehet Lajçi, i cili ka familje

shtatanëtarëshe.

Mbi 2.5 miliardë euro është vlëra financiare që qytetarët e Kosovës kanë shpenzuar për konsum, gjatë vitit 2022. Pjesa më e madhe e këtij buxheti është shfrytëzuar për ushqim dhe pije joalkoolike. Kosova e ka mbyllur vitin 2022 me një normë mesatare inflacioni prej 11.6-përqindësh, kurse në muajin shtator të këtij viti norma e inflacionit ka qenë 4.2 për qind.

Për rrjedhojë, thotë mësimdhënësi 62-vjeçar, vlëra e koeficientit duhet të jetë mbi 150 euro. "Tash është fundi i muajit. Lutem të mos kem nevojë për ndonjë kontroll te mjekët, sepse nuk ia dal dot. Deri në gjysmën e muajit - nëse nuk kam probleme shëndetësore - e kaloj, e kaloj me pagë. Gjysmën tjetër, nuk e di...", thotë ai, pa vazhduar më gjatë.

Mundësinë e rritjes së koeficientit të pagave, Kuvendi i Kosovës e nxori të enjten në një seancë të jashtëzakonshme, por votimi për projektrezolutën u shty në mungesë të kuorumit.

Seanca u iniciua nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e cila kërkoi që koeficienti i pagave të rritet në 129 euro, dhe u mbështet

nga partitë e tjera opozitare.

Por, para fillimit të debatit parlamentar, Mimoza Kusari-Lila, shefe e grupit parlamentar e partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, kërkoi që të përmbillen fillimisht pikat e mbetura të seancave të kaluara, pastaj të vazhdohen punimet e seancës së jashtëzakonshme.

Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, nuk pranoi kështu dhe Vetëvendosja e braktisi seancën. Në debatin që vazhdoi, Besnik Tahiri i AAK-së tha se rritja e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve ka shkaktuar "situatë alarmante". Ai tha se vlëra e koeficientit të pagave duhet të rritet në kuadër të buxhetit të shtetit për vitin 2024. "Kjo do të thotë rritje e fondit vjetor të pagave për 23 për qind, ose në shifra absolute nga 745 milionë euro - aq sa është fondi i pagave për këtë vit - të shkojë në 916 milionë euro", tha Tahiri.

Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, tha se qytetarët, për shkak të pagave të ulëta, po e braktisin Kosovën. "Njerëzit janë duke parë çdo mundësi për të ikur nga

Kosova, për një jetë më të mirë, për të ardhmen e fëmijëve të tyre", tha Tahiri.

Besian Mustafa nga Lidhja Demokratike e Kosovës tha se është "fatkeqësi" refuzimi i partisë në pushtet për të debatuar për çështje në interes të qytetarëve. "Në tre vjetët e këtij pushteti 2021, 2022 dhe tashmë më 2023... inflacioni i përgjithshëm ka kaluar shifrën mbi 20 për qind, ndërsa nëse e analizojmë inflacionin te produktet esenciale, e kalon normën prej 100-përqindësh", u shpreh Mustafa.

Mejdi Bektashi, profesor i ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, thotë se qeveria duhet ta rrisë vlerën e koeficientit të pagave për shkak të inflacionit. Sipas tij, vlëra aktuale është e pamjaftueshme për mirëqenie sociale dhe, njëherësh, nuk siguron punë efektive. "... sepse, nuk ka rritje të madhe të të punësuarve në sektorin publik. Prandaj, rritja e koeficientit nga 105 në 129 euro do të ndikonte në uljen e tensioneve sociale në Kosovë. Me këtë koeficient, aktualisht, është shumë vështirë të përballohet inflacioni", thotë

Bektashi për "Radion Evropa e Lirë".

Për më tepër, shton ai, qeveria ka mundësi ta rrisë buxhetin e përgjithshëm për pagat. "Qeveria nuk është në gjendje ta shpenzojë buxhetin... Edhe fondi për pagat, prej rreth 750 milionë eurosh, do të ketë teprica të theksuara - deri në 20 për qind - për shkak të pensionimit të punëtorëve, mospunësimit të punëtorëve të rinj...", thotë Bektashi.

Buxheti i shtetit të Kosovës për këtë vit është 3.2 miliardë euro. Mjetet buxhetore që nuk shpenzohen gjatë vitit fiskal kthehen në suficit apo në projekte të tjera. Në gjashtëmujorin e parë të këtij viti suficiti ka arritur në 52.9 milionë euro.

Në sektorin publik të Kosovës janë mbi 83 mijë punonjës. Sipas Agjencisë së Statistikave në vend, paga mesatare është 521 euro. Pagat më të larta në Kosovë në vitin 2022 kanë qenë në sektorin e energjisë - rreth 970 euro, tregojnë të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Më së paku janë paguar punonjësit në akomodim dhe shërbime me ushqim - rreth 320 euro.

## Ambasadori i BE-së: Jemi të interesuar të përshpejtojmë një tranzicion të drejtë energjetik

**PRISHTINË, 27 TETOR** - Nën organizimin e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë është mbajtur punëtorja për gazetarë të medieve të ndryshme në Kosovë me temën "Bëjeni realitet tranzicionin energjetik, bëni tranzicionin të drejtë - në Kosovë", i cili për qëllim kishte ngritjen e kapaciteteve të gazetarëve

për raportim të drejtë për kalimin nga një energji e ndotjes në një energji më të pastër.

Nga të pranishmit u kërkua gjithëpërfshirja e individëve në këtë drejtim, pasi u theksua se ky tranzicion është një zgjidhje ekonomike më e përshtatshme dhe më e shëndetshme për gjithë shoqërinë.

Ambasadori i Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, tha se përmes iniciativave të ndryshme janë të interesuar të përshpejtojmë një tranzicion të drejtë duke mos lënë asnjë regjion prapa. Szunyog tha se qëllimi është të ndihmohet Ballkani Perëndimor që ta planifikojë kalimin nga një energji e ndotjes në energji të pastër.





# Intrigat sovjetike të vitit 1956, për ndërhyrjen ushtarake në Hungari



**Nga: Përparim KABO**

Historia na kujton se para se të dëgjojmë krismat e armëve dhe të shohim si vriten njerëzit, do të duhet të hyjmë në ato hapësira të errëta, ku jepen komandat, dhe të njohim gjithashtu se cilët janë njerëzit që i marrin këto vendime. Duhet hedhur dritë se si gjykohej dhe diskutohet atje, sa kushton jeta e njeriut për ata që luftën e quajnë zgjidhje? Cilat janë motivet dhe shkaqet apo argumentet që parashtrihen për të thënë atje fillimisht: “Zjarri!” Më tej, bota shoh shfaqjen reale, që duket sikur është historia që ne duhet të njohim. Është një tezë e pranuar nga historiografia shkencore, se në gjykimin e ngjarjeve duhen faktet e besueshme, por, përveç tyre, ka shumë rëndësi interpretimi që u bëhet. Nëse faktet nuk janë të mjaftueshme, mund të nxirren përfundime jo të drejta dhe jo shteruese, që e lënë hapur diskutimin. Por, nëse interpretimi i fakteve historike është jo i saktë, shtrembërimi atëherë është në dëm të të gjithë historisë. Ndaj, për ngjarjet e 1956-s hungareze, është e nevojshme që të hedhim dritë për të njohur vendimet e marra nga Kremli zyrtar në ditët e fundit, në tetor të vitit 1956.

Presidiumi i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik e diskutoi çështjen hungareze në 28 tetor 1956. Shefi i KGB-së, Serov, [1] informoi udhëheqjen sovjetike duke deklaruar para saj, krejt ndryshe se si ishte gjendja – pra, kemi rastin ku manipulohet me faktet. Për pasojë

edhe interpretimi i tyre si dhe përfundimet që nxirren, janë jo në përputhje me realitetin.

Në studimin e tij për këtë problematikë, studiuesi hungarez, Miklós Horváth, [2] shkruan: “Në kundërshtim me kushtet aktuale mbizotëruese, Serovi deklaronte se: ‘Kryengritësit në Budapest ishin të pasigurt për vazhdimin e rezistencës. Më aktivët favorizuan vazhdimin e luftës. Ata do të pranonin një armëpushim, vetëm me kushtin që të mund të mbanin armët dhe do të rifillonin më së shumti luftimet në mundësi më të favorshme.’” [3] Ky, lloj spekulimi i shefit të KGB-së, linte të kuptonte se atje janë armatosur, se ata nuk duan “ndalim zjarri,” se pjesa më e madhe e tyre pret mundësinë që të godasë edhe në befasi. Pra, ne duhet të jemi vigjilentë dhe të gatshëm për t’i neutralizuar dhe asgjësuar. Sa herë e kemi takuar në histori këtë lloj argumenti të fabrikuar, thjesht si motiv për të mbushur armët dhe për t’i zbratur ato! Pra, nga një histori e paqenë, nga një realitet disi i sajuar, u ngritën ngjarjet që pasuan dhe u zhvillua një histori, sa hungareze, po aq edhe sovjetohungareze, sa evropiane, po aq edhe botërore. Hrushovi që foli në fillim të sesionit, më datën 28 tetor, tha shkurt dhe në mënyrë të thukët, por tejet provokuese: “Situaata është duke u bërë edhe më serioze.”

Pas këtij lloj “zjarri” retorik, ai që i hodhi benzinë ‘flakëve’ ishte Voroshilovi, i cili u shpreh se duhej vepruar, por me dredhi dhe oportunitet opinionbërës, me qëllim që faktori ndërkombëtar të “hante sapunin për djathë.” Duhej krijuar “argumenti” se ishin

pikërisht udhëheqësit komunistë hungarezë, të cilët ndienin rezikun, dhe se ishin po ata që po kërkonin ndihmën sovjetike në kuadrin e Traktatit të Varshavës dhe Kampit Socialist.

Por, si ishte situata në palën hungareze?

Në udhëheqjen e lartë komuniste hungareze, jo të gjithë ishin pro-sovjetikë. Populli hungarez, rinia shkollore dhe ajo studentore, intelektualët dhe ata që frekuentonin “Klubin Petef,” punëtorët dhe punonjësit e medias (së paku një pjesë e tyre) ishin për një Hungari jashtë bllokut sovjetik, për një Hungari të pavarur dhe demokratike, me pluralizëm politik dhe ku duheshin organizuar zgjedhje të lira dhe të drejta. Revolucioni hungarez i 1956-s, kërkonte një Hungari jashtë blloqeve, pra një Hungari neutrale. Këto ide ata i lidhnin me risjelljen në skenën politike të Imre Nagyt. Ndërsa, plani sovjetik shikonte si subjekt kyç në grupin pro-sovjetik të udhëheqjes komuniste hungareze, János Kádárin. Voroshilovi [4] sugjeroi që trupat sovjetike të mos tërhiqeshin dhe kryengritja të shtypej me forcë. Presidiumi duhej të përgatiste programin e tij dhe duhej të merrte mbështetjen e një grupi të rëndësishëm hungarez për programin. [5] Kjo ishte deklarata e parë e paqartë, që bënte thirrje për mbështetjen e grupit të rëndësishëm hungarez, si kusht për të shtypur kryengritjen. Siç tregojnë komentet e mëpasshme, një numër në rritje i anëtarëve të Presidiumit shpresonin, prisnin, madje kërkuan nga János Kádári, si aktori kryesor, një zgjidhje të pranueshme për

udhëheqjen sovjetike. Më qartë se kaq nuk ka ku shkon, “një zgjidhje të pranueshme për udhëheqjen sovjetike.” Me një gjuhë makiaveliste Voroshilovi qartazi lë të kuptohet që zgjidhja të mos prekte ligjet ndërkombëtare, të mos krijonte reaksion te faktori ndërkombëtar dhe në institucionet ndërkombëtare.

Është fakt tashmë i njohur, që problemi hungarez shkoi aso kohe në OKB dhe u ngrit edhe një komision hetimor. [6] Një kurth i tillë të sjell në mendje atë që sajoi Hitleri me pakicën gjermane në Çeki dhe në Poloni, për të ndërhyrë atje. Po kështu, është e njëjta mënyrë që u përdor me pakicat ruse në Ukrainë dhe gjetjen e motiveve për shpërthimin e luftës mes Rusisë dhe Ukrainës. Në të gjitha rastet, ata që paguajnë janë popujt, civilët e pafajshëm, deri edhe fëmijët. Duket si një marrëzi e vullneteve të shtrembra, që në mënyrë ciklike e risjellin këtë lloj qëndrimi dhe po ata përipiqen me alibi të fshihen pas gishtit. Duke filluar nga ngjarjet e 1956-s në Hungari, logjika e Bashkimit Sovjetik dje, dhe pas 1990-s e Rusisë, deri në ditët tona, ka qenë dhe mbetet: “Nëse del nga zona ime e influencës,” unë do e gjej shkakun dhe argumentet, që ta shtrij këtë influencë sërish, duke përdorur të gjitha mjetet, që nga diplomacia, mjetet ekonomike dhe deri te ato ushtarake. Nuk habitemi që ende Rusia e shekullit XXI, në rastin e ndërhyrjes në Ukrainë, ka (ri)sjellë në retorikën e saj raportet e forcave mbas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, si dhe premtimet e fuqive të mëdha, pas rënies së Murit të Berlinit dhe bashkimit të dy

Gjermanive. E gjitha kjo retorikë përdoret nga propaganda zyrtare, me qëllim për të avancuar argumentin se ShBA-ja, Perëndimi dhe NATO, nuk i kanë mbajtur premtimet. Ne jemi të detyruar përballë historisë t’u kundërpërgjigjemi atyre me të gjitha arsenalet që ne zotërojmë.

Winston Churchill kishte paralajmëruar herët, që në vitin 1946, se çfarë pritej të ndodhte me ato vende ku kishte prezencë ushtarake sovjetike. “Varshava, Berlina, Praga, Vjena, Budapesti, Beogradi, Bukureshti dhe Sofja, të gjitha këto qytete të famshme ... shtrihen në atë që duhet ta quaj sfera sovjetike, dhe të gjitha i nënshtrohen në një formë ose në një tjetër, jo vetëm ndikimit sovjetik, por një mase kontrolli shumë të lartë dhe në shumë raste në rritje nga Moskë.” [7] Churchilli po nuhaste ngritjen e një konflikti të ri mes blloqeve. Ndofta, ai ishte i pari që kuptoi se po krijohet ajo që u quajt “Lufta e Ftohtë,” pas ngjarjeve në Hungari. Në mbledhjen e Presidiumit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, më 31 Tetor 1956, Hrushovi deklaroi në lidhje me raportin e forcave: “[Ne] nuk duhet t’i tërheqim trupat tona nga Hungaria dhe Budapesti ... Nëse largohemi nga Hungaria, kjo do t’u japë një shtysë të madhe amerikanëve, anglezëve dhe francezëve – imperialistëve. Ata do ta perceptojnë atë si dobësi nga ana jonë dhe do të shkojnë në ofensivë. Atëherë do të ekspozonim dobësinë e pozicioneve tona.” [8] Ky argument ngjan si dy pika uji me ato që thotë sot Putini: Po të largohemi

ne nga Ukraina apo nga ish-republikat e tjera sovjetike, atje do afrohet NATO, Amerika dhe Britania e Madhe. Këngë e vjetër, për histori të reja. Në thelb, është e njëjta filozofi dhe sjellje politiko-ushtarake. "Historia magistra vitae est" (Historia është mësuësja e jetës), siç thoshin latinët. Puna është si e lexon historinë: si riciklim apo si zhvillim drejt lirisë?

Aso kohe, në vjeshtë të vitit 1956 ndodhi që, pavarësisht denoncimit të Stalinit nga Hrushovi, tashmë ishte e qartë se Bashkimi Sovjetik do të vepronte për të ruajtur komunizmin në vendet që konsideroheshin strategjikisht të rëndësishme, edhe nëse kjo nënkuptonte shtypjen e lëvizjeve popullore. Kështu u motivua ndërhyrja në Hungari. Ja si është shprehur në atë kohë Hrushovi, në një fjalim para aktivistëve të partisë, më 4 nëntor 1956: "Ne, në Presidium, menduam shumë për situatën në Hungari dhe ishim shumë të shqetësuar që ngjarjet që po ndodhin në Hungari të mos përhapeshin në vende të tjera."<sup>[9]</sup> 12 vite më vonë, ndërhyrja e armatosur në Çekoslovakë, gjatë Pranverës së Pragës më 1968, ndoqi një model të ngjashëm me Hungarinë. Doktrina e "Sovranitetit të Kufizuar" u shpall nga udhëheqësi sovjetik, Leonid Brezhnev, pas ndërhyrjes në Çekoslovakë. Ai u shpreh se, një kërcënim për sundimin komunist në një vend në bllok, ishte një kërcënim për sundimin komunist në të gjitha vendet dhe një ndërhyrje e justifikuar. Brezhnjevi e përdori këtë për të justifikuar në mënyrë retroaktive ndërhyrjen e dikurshme në Hungari dhe do të përdorej më vonë për të justifikuar pushtimin sovjetik të Afganistanit. Sot Putini e ka modifikuar, duke thënë se afrimi i NATO-s është kërcënim për ne, ndaj Rusia merr masa dhe është e gatshme të përgjigjet me të gjitha mjetet, duke lënë të nënkuptohet deri edhe armët atomike.

Le të kthehemi te kronika e atyre tri ditëve fatale për popullin hungarez, për të mësurar me detaje se si u diskutua në ato mbledhje të udhëheqjes sovjetike dhe pse u vendos që të ndërhyhej ushtarakisht, duke mos marrë parasysh se armët vrasin jo vetëm palën tjetër, që i mban ato dhe është kundërshtari yt, por edhe të pafajshëm, vrasin civilë, të rinj, pleq dhe fëmijë. Armët vrasin jetën! Kjo shprehje do të duhet të shkruhet në të gjitha librat e historisë, në të gjitha dokumentet ndërkombëtare dhe, pse jo, në të gjitha kushtetutat. "Gjatë Revolucionit Hungarez të vitit 1956, Mikahil Suslovi, së bashku me Anastas Mikoyan, operuan në afërsi të Budapestit për të drejtuar aktivitetet e trupave sovjetike dhe për t'i dhënë ndihmë udhëheqjes së re hungareze. Suslovi dhe Mikoyani morën pjesë në mbledhjen e Byrosë Politike të Partisë Socialiste të Punëtorëve Hungarezë, e cila zgjodhi János Kádárin në postin e Sekretarit të Përgjithshëm. Në një telegram drejtuar udhëheqjes sovjetike, Suslovi dhe Mikoyani pranuan se situata ishte bërë më e rëndë, por të dy ishin të kënaqur me shkarkimin e Ern Ger s, si Sekretar i Përgjithshëm dhe zgjedhjen e Kádár, si pasardhës të tij."<sup>[10]</sup> Sipas Suslovit, i thirrur të linte Budapestin për takimin në udhëheqjen e lartë

komuniste sovjetike, "duhej të krijohet një qeveri relativisht e fortë dhe të shtyheshin zgjedhjet, por trupat sovjetike duhet të përgatiteshin të tërhiqeshin nga Budapesti. Në mënyrë energjike, Voroshilovi kundërshtoi, duke argumentuar se prania e trupave sovjetike është mëse e domosdoshme dhe ato nuk duhet të tërhiqen, duke u trajtuar si trupa armike. Këtu ka një element shumë delikat, që meriton edhe sot më shumë dritë shpjeguese. Trupat sovjetike hynë si çlirimtare në fund të Luftës së Dytë Botërore, por ato mbeten atje si pushtuese. Populli hungarez nuk i donte më, madje as edhe në kazerma ku ishin të dislokuara. Trupat sovjetike kishin disa muaj që ishin larguar edhe nga Austria, e cila ishte shpallur një shtet neutral. Trajtimi i forcave sovjetike si armike, do të hapte një kapitull të ri në arenën evropiane dhe më gjerë. Këto trupa me tytat e nxehta po impononin një sistem politik të padëshiruar. Komunizmi bolshevik sovjetik po vinte pas Luftës së Dytë Botërore si një sfidë ndaj demokracisë borgjeze, që bazohej te pluralizmi politik dhe zgjedhjet e lira dhe të ndershme, tek prona private dhe liritë dhe të drejtat e njeriut. Ajo çfarë kishte paralajmëruar, gati një dekadë më parë, George Kennan, po ndodhte në Hungarinë e 1956-s, ku me forcën e armëve u shtyp Revolucionit Demokratik Hungarez. U vërtetua natyra imperialiste ushtarake e Bashkimit Sovjetik. "Në vitin 1946, ndërsa ishte i Ngarkuar me Punë në Moskë, Kennan, i dërgoi Departamentit të Shtetit një telegram me 8 000 fjalë" – "telegrami i gjatë" tashmë i famshëm, mbi natyrën agresive të politikës së jashtme të Stalinit. Kennan, duke shkruar si "Z. X," botoi një përmbledhje të filozofisë së tij në revistën prestigjioze "Foreign Affairs," në vitin 1947. E gjitha kjo politikë e Bashkimit Sovjetik u provua në Hungarinë e 1956-s, sepse atje u kërkua rikthimi i pluralizmit politik, dalja nga Traktati Varshavës, dhe një Hungari e pavarur dhe neutrale. Prania e forcave sovjetike dhe përdorimi i forcës së armëve, pohoi se Hungaria ishte jo një vend që gëzonte lirinë, por një vend praktikisht i pushtuar. Në mbledhjet e famshme të udhëheqjes së lartë sovjetike, në një klimë diskutimesh okulte për 2-3 ditë, u parashtruan mendimet dhe alternativat mes debateve të nxehta. Disa prej liderëve sovjetikë theksuan se ishin dakord me vendimin tashmë të marrë, sepse dukej se nuk kishte alternativë tjetër, por duhet të mbështetej qeveria aktuale. Ka pasur një moment kundërshtie mes Voroshilovit dhe Krushovit, jo parimore, por në vlerësimin e gjendjes, e cila përshkallëzohej në terren nga ora në orë. Voroshilovi shprehu si shqetësimin madhor shpërthimin e luftës, nëse trupat sovjetike do të tërhiqeshin dhe nuk do të kishte asnjë grup mbështetës. "Hrushovi hodhi poshtë opsionin e një ndërhyrjeje të re ushtarake në atë kohë." Ndryshe nga mendimi i Dmitri Shepilovit (i cili zëvendësoi Vyacheslav Molotovin si ministër i Jashtëm në vitin 1956), që këmbëngulte se "kundër komunizmit nacional" duhet luftuar me forcë. Georgi Zhukov, generali i famshëm, heroi i Luftës së

Dytë Botërore, aso kohe ministër i Mbrojtjes, propozoi që trupat të tërhiqen nga Budapesti, nëse është e nevojshme edhe nga Hungaria. Zhukovi, madje, rekomandoi tërheqjen e trupave sovjetike, kur dukej se ata do të duhej të merrnin masa ekstreme për të shtypur revolucionin. Gjendja në Presidium ndryshoi përsëri, kur kryeministri i ri i Hungarisë, Imre Nagy, filloi të fliste për tërheqjen e Hungarisë nga Traktati i Varshavës. Kjo deklaratë bëri që sovjetikët të sulmonin revolucionarët dhe tazëvendësonin Nagyin me János Kádárin. Në këtë situatë, së bashku me shumicën e anëtarëve të Presidiumit të Komitetit Qendror, ai i kërkoi Hrushovit të dërgonte trupa për të mbështetur autoritetet hungareze dhe për të siguruar kufirin austriak. Në vijim të debateve Presidiumi i Komitetit Qendror të PKBS, dëgjoi raportimin e Pavel Yudin, filozof, sociolog dhe diplomat. Judini ishte ambasador sovjetik në Kinë, nga 3 dhjetori 1953 deri më 15 tetor 1959. Ai u rizgjodh në Komitetin Qendror në Kongresin e 20-të të Partisë, në vitin 1956 (gjatë të cilit Hrushovi mbajti Fjalimin e Fshehtë, që ekspozonte krimet e Stalinit.) Në këtë periudhë ai kishte qenë ndërmjetës me udhëheqjen e lartë kineze. Ai solli në mbledhjen e Presidiumit pyetjet që kishin shtuar kinezët dhe argumentet e tyre gjithë po aq. Dhe, konkretisht: Cila është situata? A do Hungaria të shkëputet nga kampi ynë? Kush është Imre Nagy? A mund ne t'i besojmë atij? Siç tregon procesverbali, presidiumi ftoi Liu Shao Chi të bashkohej në seancë. Ai dha përgjigje të përgatitura në pyetjen e Presidiumit. Li Shao Chi deklaroi qëndrimin e rishikuar të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Kineze: "Trupat duhet të qëndrojnë në Hungari!"<sup>[11]</sup> Ndërkohë që debatet gëlonin në Kremlin dhe kinezët sollën mesazhin: "Të mos largohen trupat ushtarake!", në Hungari nuk kishin informacion se çfarë po gatuhej. Situata paraqitej goxha e turbullt, sepse nga njëra anë udhëheqja sovjetike deklaronte, më 30 tetor 1956, se do respektoheshin "Parimet e barazisë së plotë, integritetit territorial, pavarësisë dhe sovranitetit dhe mosdërhyrja në punët e brendshme e në marrëdhëniet e ndërsjella të shteteve socialiste." Por, nga ana tjetër, po qeveria sovjetike deklaronte se ishte e gatshme të shqyrtonte çështjen e forcave pushtuese sovjetike në vendet socialiste, pjesëmarrëse në Traktatin e Varshavës, mbi bazën e parimit se "stacionimi i forcave të një shteti në territorin e një shteti tjetër, është e lejuar vetëm me pëlqimin e atij shteti në të cilin janë të pranishme këto forca." Çengeli ishte varur! Po qe se e kërkon qeveria e shtetit, anëtar i Paktit të Varshavës, ne shkojmë në ndihmë edhe ushtarakisht. Duhej gjetur personi që do "lidhej" në këtë çengel. Si ndodhi? Presidiumi i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të BS-së zhvilloi një sesion të zgjeruar ku mermin pjesë János Kadar, Ferenc Münnich dhe István Bata. Kadari ishte takuar me Ferenc Münnichun, natën vonë, më 1 nëntor. Po negocihohej me Komitetin Administrativ të Partisë Socialiste të Punëtorëve Hungarezë

dhe ambasadorin kinez në Hungari. Me sa duket, Andropovi, ambasadori sovjetik në Hungari, ndryshoi gjendjen dhe Kadari e Münnichu, me një automjet të blinduar, shkuan në bazën ajrore Tokol dhe prej andej fluturuan në Moskë. Fillimisht, Kadari shpreh qartazi mendimin e përgjithshëm se kërkohej largimi i forcave ushtarake sovjetike, se Hungaria nuk pranonte më varësinë dhe se askush nuk donte që vendi të kthehej në fushë gjakderdhjeje. Parulla ishte: "Le të bashkohemi për fitoren e një Hungarie të pavarur dhe një Hungarie të lirë!" Kthesa fatale ndodhi në mbledhjen e datës 2 nëntor 1956. Janos Kadari mori trajtën e një njeriu të dobët, që i shprehte udhëheqjes sovjetike se çfarë po ndodhte, duke u nënshtruar dhe në formën e një personi që lyp ndihmë nga halli që e ka zënë. Ai bëri një tablo se cilat ishin forcat dhe çfarë kërkonin. Personalisht dukej se ai po metamorfozohej, duke u zhytur në një pozicion të ndërmjetëm. Ishte i turbullt dhe diabolik, thjesht një person që ishte thyer brenda vetes dhe në atë gjendje dobësie kërkonte të gjente jo argumente, por justifikime. Psh., kur u tha në atë takim se "deklarata për të shpallur neutralitetin u bë gjithashtu për shkak të ndikimit që pati ardhja e trupave të reja sovjetike," nuk shprehte të vërtetën historike. Që në zgjedhjet e para të përgjithshme, pas Luftës në Hungari, forcat politike tradicionale jo komuniste ishin shprehur për një organizim shoqëror dhe politik jo komunist. Gjuha e Kadarit, as mish e as peshk, larg të vërtetave konkrete në Hungari, u zbrëthye pa pengesa nga Ferenc Münnichu i cili komplimentoi evoluimin e Kadarit, por ai vetë doli hapur kur deklaroi: "Sistemi socialist në Hungari ekziston dhe do të mbijetojë vetëm me mbështetjen e Bashkimit Sovjetik." Pra, ky është sistemi, BS është garanti. Kush do dilte nga kjo "nofull," do hynte në konflikt me udhëheqjen komuniste hungareze por sovjetike, por edhe me Bashkimin Sovjetik. Ndryshe mund të lexohet: "Sovraniteti ynë lidhet me sistemin socialist dhe nuk ka alternativë ndryshe, dhe ky sovranitet ka si garant shtetin sovjetik." Po atë ditë, në një sesion tjetër, pala hungareze nuk u ftua. Atje u diskutua dhe u miratua plani i ndërhyrjes ushtarake. Plani operacional u emërtua "Vorbull" (në rusisht "Vikhr," në hungarisht "Forgószel"). Më datën 3 nëntor 1956, sesioni i zgjeruar i Presidiumit të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, diskutoi përbërjen e qeverisë së re hungareze, e cila do formohej me mbështetjen e Bashkimit Sovjetik. Pas konsultimit edhe me palën jugosllave, u ra dakord që kreu i qeverisë të ishte János Kádár. Ky pion (gur shahu) politik nuk nguroi që të hiqte dorë nga çfarë kishte thënë kur mbërriti në Moskë dhe të deklaronte: "Nuk është e pranueshme të lejohet që kundërrevolucionin të pushtojë një vend socialist. Ne jemi dakord me ju. Zgjidhja e duhur është formimi i një qeverie revolucionare." Mbledhja e Presidiumit të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, pra, kuzhina ku u gatua dhe u urdhërua ndërhyrja në fillim të nëntorit 1956, në Hungari, u mbyll

me vendimin se qeveria hungareze, që do drejtohej nga Kádári, do të kishte në përbërje: Ferenc Münnich, György Marosán, Imre Horváth, István Kossa, Antal Apró, Imre Dögei dhe Sándor Rónai. Një qeveri kukull, që i tha pushtuesit: "Ju lutem, ejani na shpëtoni nga (kundër) revolucionarët" Kur mendon se çfarë po ndodh në Ukrainë sot dhe si u sajua ndërhyrja ruse, nuk ke pse habitesh. Ja përse kanë shumë vlerë edhe sot ato çka deklaroi aso kohe Imre Nagy: "Kjo luftë është lufta për liri e popullit hungarez kundër ndërhyrjes ruse dhe është e mundur që unë të mund të qëndroj në postin tim vetëm një ose dy orë. E gjithë bota do të shohë se si forcat e armatosura ruse, në kundërshtim me të gjitha traktatet dhe konventat, po shtypin rezistencën e popullit hungarez. Ata do të shohin gjithashtu se si po rrëmbejnë kryeministrin e një vendi anëtar të Kombeve të Bashkuara, duke e marrë nga kryeqyteti dhe për këtë arsye nuk mund të vihet aspak në dyshim se kjo është forma më brutale e ndërhyrjes. Do të doja që në këto momente të fundit t'u kërkoja liderëve të revolucionit, nëse mundën, të largohen nga vendi. Unë kërkoj që gjithçka që kam thënë në transmetimin tim dhe për çfarë kemi rënë dakord me liderët revolucionarë, gjatë takimeve në Parlament, të futet në një memorandum dhe liderët t'u drejtohen të gjithë popujve të botës për ndihmë dhe shpjegim. Se, sot është Hungaria dhe nesër ose pasnesër, radha e vendeve të tjera, sepse imperializmi i Moskës nuk njeh kufij dhe po përpiqet vetëm të luajë me kohën." Kjo fjalë, "Sot është Hungaria dhe nesër ose pasnesër, radha e vendeve të tjera, pasi imperializmi i Moskës nuk njeh kufij," vlen më shumë se të gjitha fjalimet që mbahen sot në forumet ndërkombëtare!<sup>[12]</sup>

[1] Gjenerali i Sigurimit të Shtetit, [Ivan Alexandrovich Serov](#) (rusisht: á á ó, 13 gusht 1905–1 korrik 1990) ishte udhëheqës i shquar i Agjencive të Sigurisë dhe Inteljencës Sovjetike – kreu i KGB-së midis marsit 1954 dhe dhjetorit 1958, si dhe kreu i GRU-së ndërmjet viteve 1958 dhe 1963. Ai ishte zëvendëskomisar i NKVD-së nën Lavrentij Beria dhe do të luante një rol të madh në intrigat politike pas vdekjes së Stalinit. Serovi ndihmoi në krijimin e një sërë forcash të policisë sekrete në Evropën Qendrore dhe Lindore pas ngritjes së Perdes së Hekurt dhe luajti një rol të rëndësishëm në shtypjen e Revolucionit Hungarez të vitit 1956.

[2] [Miklós Horváth](#) është nënkolonel i ushtrisë hungareze dhe studiues i Institutit të Historisë Ushtarake Hungareze në Budapest. Ai ka botuar gjerësisht mbi temën e Revolucionit Hungarez të vitit 1956 dhe ka përkthyer shumë dokumente origjinale nga burimet ruse.

[3] The Hungarian Revolution and War for Independence, p.432-433.

[4] [Kliment Yefremovich Voroshilov](#) (1881–1969), udhëheqës ushtarak dhe politik i Bashkimit Sovjetik, i cili shërbeu si kreu i shtetit pas vdekjes së shokut dhe bashkëpunëtorit të tij të ngushtë, Joseph Stalin.

[5] Döntés a Kremblen, 1956, eds.Sereda and Rainer, p.36.

[6] Për këtë komision dhe punën e tij është folur në një rast tjetër, Kabo. P

[7] [Winston Churchill](#), The Sinews of Peace, 5 mars 1946.


[8] [Nikita Khrushchev](#) at Meeting of CPSU Presidium, 31 tetor.

[9] Shih: <https://www.hellovaia.com/explanations/history/us-history/hungarian-revolution/>

[10] Brown, Archie (2009). The Rise & Fall of Communism. London: Bodley Head.

[11] The Hungarian Revolution and War for Independence, p. 435.

[12] Shih: <https://web.viu.ca/davies/H102/Nagy.LastSpeech.1956.htm>



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Kosova realizon fitoren e parë në Ligën e Kombeve

Shkup, 27 tetor - Kombëtarja e Kosovës në konkurrencën e femrave ka shënuar fitoren e parë në Ligën e Kombeve. "Dardanet" të premtën në Shkup kanë shënuar fitore në përballje me Maqedoninë e Veriut me rezultat 2:0. Kjo ndeshje i ka takuar xhiros së dytë të Grupit 5 në Ligën C. Të përzgjedhurat e Anneli Andersen kanë dominuar në ndeshje që nga fillimi dhe kanë krijuar raste të njëpasnjëshme, teksa rezultati është zhbllokuar në minutën e 20. Valentina Limani me

gjuajtje të fortë e të saktë nga rreth 20 metra ka arritur ta çojë topin në rrjetën e portës së Magdalena Lekovkës për rezultatin 1:0.

"Dardanet" kanë vazhduar me lojë të mirë edhe në vazhdim të pjesës së parë dhe, si rrjedhojë, kanë arritur ta gjejnë edhe golin e dytë. Në minutën e 41-të Kaltrina Biqkaj ka harkuar nga krahu i djathtë, derisa reagimin e dobët të portieres Lekovska e ka shfrytëzuar Valentina Metaj, e cila nga afërsia ka shënuar për 2:0. Edhe në pjesën

e dytë futbollistet "dardane" kanë bërë paraqitje të mirë dhe e kanë administruar epërsinë e pjesës së parë, duke mos i lejuar futbollistet vendase ta rrezikojnë portën e Alma Demirit. Pas kësaj fitoreje, Kosova ka 4 pikë dhe kryeson renditjen, aq sa ka edhe Bullgaria në pozitën e dytë. Ndeshjen e radhës "Dardanet" e zhvillojnë të martën (më 31 tetor), sërish kundër Maqedonisë së Veriut, në stadiumin "Fadil Vokrri" në orën 17:00.



## Superliga e Kosovës në futboll vjen me ndeshje interesante

Prishtinë, 27 tetor - Sot (e shtunë) do të luhen dy ndeshje në kuadër të xhiros së 11-të të Superligës së Kosovës në futboll. Ndeshja më interesante do të jetë ajo në mes të Prishtinës dhe Gjilanit. Kryeqytetasit në këtë përballje hyjnë me trajner të ri pas largimit të Debatik Currit.

Kryeqytetasit kërkojnë fitore në këtë ballafaqim, pasi nuk dinë për të tash e shtatë javë, derisa të kuqtë nga Gjilani kërkojnë fitoren e dytë radhazi.

Takimi i parë i luajtur në mes të tyre kishte përfunduar pa gola. Sa i përket tabelës, Prishtina ka 13 pikë, dy më shumë se Gjilani.

Po ashtu, sot (e shtunë) Fushë-Kosova e pret Malishevën, që



paraqitet me trajner të ri. Në pesë sfidat e fundit malishevasit kanë katër humbje, aq sa ka edhe

Fushë-Kosova. Në tabelë Malisheva qëndron e pesta, derisa mbyllet nga Fushë-Kosova.

Malisheva e kishte dekluar kundërshtarin në takimin e parë, 6:1.

Dy skuadrat e para të tabelës, Ballkani dhe Drita, priten të kenë përballje të lehta këtë javë, të paktën në letër. Suharekasi luajnë nesër (e diel) në udhëtim te Feronikeli 74, duke e kërkuar fitoren e tetë kampionale, karshi dy barazimeve. Në anën tjetër, Feronikeli 74 do të përpigjet të shkaktojë befasi e të marrë rezultat pozitiv. Tabelës i prin Ballkani me 23 pikë, kurse Feronikeli është i teti me 11 pikë. Përballja e parë u kishte takuar therandasve me rezultat 2:0.

Përcjellësja më e afërt e Ballkanit, Drita, këtë javë luan në shtëpi ndaj

Lirisë, për t'iu hakmarrë për atë barazim pa gola në sfidën e parë.

Të kaltrit nga Gjilani janë të dytë në tabelë me dy pikë më pak se ekipi i parë.

Interesante e të dy ekipeve është se Drita ka pesë fitore radhazi, ndërsa Liria pesë humbje radhazi. Prizrenasit në tabelë janë të parafundit.

Sfida e fundit do të luhet në Klinë në mes të Dukagjinit e Llapit. Të besuarit e Tahir Batatinës do ta kërkojnë fitoren e dytë ndaj atyre të Armend Dallkut, në një terren tejet të vështirë.

Sa i përket klasifikimit, llapjanët gjenden të tretit me 19 pikë, plot shtatë më shumë se klinasit të gjashtë.

## Sot luhet 'El Clasico' e Kosovës në basketboll

Prishtinë, 27 shtator - Të gjithë adhuruesit e basketbollit të Kosovës sot (e shtunë) do t'i kenë sytë kah "El Clasico" në mes të Sigal Prishtinës dhe Pejës.

Ky derbi vjen në një çast shumë të veçantë, pasi të dy skuadrat janë në top formë. Bardhekaltrit kanë katër fitore e një humbje, kurse pejanët numërojnë pesë fitore në pesë ndeshje, duke e bërë këtë sfidë edhe më interesante. Verdhezinjtë janë skuadra e vetme e pamposhtur në këtë edicion të elitës së basketbollit.

Përballjet ndërmjet Prishtinës dhe Pejës kanë qenë gjithmonë interesante, e kështu pritet të jetë edhe të shtunën.

Adhuruesit e basketbollit do të kenë mundësi të shohin një

spektakël të basketbollit, ndërsa atmosfera në këso sfida ka qenë gjithmonë elektrizuese.

Takimi i dytë ditën e sotme do të zhvillohet ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Proton Cable Prizrenit, ku momentalisht të dy skuadrat nuk janë në formën optimale, pasi kanë nga një fitore dhe katër humbje, e kjo e bën edhe më të rëndësishme këtë sfidë.

Nga një fitore dhe katër humbje kanë edhe Istogu e Vëllaznimi që përballen nesër (e diel). Sigurisht dy skuadrat synojnë fitoren e dytë në këtë edicion. Istogasi fitoren e vetme e kanë ndaj Bashkimit, kurse kuqezinjtë ndaj Golden Eagle Yllit. Takimi zhvillohet në Pejë.

Java e gjashtë në Prince Caffè

Superligë do të mbyllet me një tjetër sfidë interesante, ku do të ndeshen dy skuadrat me traditë, Bashkimi dhe Trepça. Prizrenasit kanë tri fitore dhe dy humbje, kurse mitrovicasit katër fitore e një humbje.

### JAVA 6 - PRINCE CAFFE SUPERLIGA:

Sot (e shtunë)

16:00 Sigal Prishtina - Peja  
19:00 Golden Eagle Ylli - Proton Cable Prizreni

Nesër (e diel)

17:00 Istogu - Vëllaznimi  
19:00 Bashkimi - Trepça



## Pochettino konfirmon se Broja do të jetë ende jashtë fushave

LONDËR, 27 TETOR - Trajneri i Chelsea, Mauricio Pochettino, ka konfirmuar se Armando Broja nuk do të jetë i gatshëm për ndeshjen ndaj

Brentfordit në kuadër të Premierë Ligës. Pochettino, mes të tjerash, ka folur edhe për Cristofer Nkunkun, për të cilin ka

thënë se është afër rikthimit në fushë. "Broja nuk do të jetë i gatshëm. Nkunku është duke bërë mirë, është afër, është një lojtar i rëndësishëm

për ne", është shprehur Pochettino. Sfida në mes të Chelsea dhe Brentfordit do të zhvillohet sot (e shtunë), duke filluar nga ora 13:30.



**NJOFTIM**


Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Niti Furniture” SH.P.K. me seli në Gjilan, me pronar Afrim Haziri dhe Ramadan Haziri, kanë marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810069064 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Niti Furniture” D.O.O. Gnjilane, sa vllasnikom Afrim Haziri dhe Ramadan Haziri, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810069064 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform all customers that the limited liability “Niti Furniture” L.L.C. with headquarters Gjilan, with owner Afrim Haziri dhe Ramadan Haziri, has come to the decision to quit its business: 810069064 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT**

**SWISS TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Anton Pal Dodaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e vitit të dytë dhe tretë dhe diplomën e shm.t. “Nexhmedin Nixha”.

- Jeton Laskaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e lëshuar nga “Qendra për Aftësi Profesionale” drejtimi - Saldues.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

